



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 107/3 Prot

Tiranë, më 10.3.2016

VENDIM

Nr. 06 ,datë 10.3 .2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit, *klinika "GLOBE"*, sh.p.k.,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit Nr. 10, datë 28.01.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 03.02.2016, filloi procedura e kontrollit administrativ pranë kontrolluesit klinika "*GLOBE*" sh.p.k, me objekt kontrolli:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit klinika "*GLOBE*" sh.p.k., i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Nga hetimi administrativ në vend, në datë 03.02.2016 e vazhdim, pranë kontrolluesit klinika "*GLOBE*" sh.p.k., grupi i kontrollit konstatoi se:

Grupi i kontrollit konstaton se kontrolluesi klinika "*GLOBE*" sh.p.k, ushtron aktivitet në fushën e shëndetësisë, dhe ka njoftuar në 04.03.2013, pranë zyrës së Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave, në zbatim të nenit 21-22 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*".

Sa i përket përpunimit të të dhënave imazhe-video nëpërmjet sistemit CCTV, grupi i kontrollit konstaton se kontrolluesi nuk e ka të instaluar këtë sistem.

1-Grupi i kontrollit gjatë verifikimit të dokumentacionit konstatoi se kontrolluesi klinika "*GLOBE*" sh.p.k, ka një rregullore të përgjithshme, ku në të është pasqyruar çdo aspekt profesional me profil mjekësor, por asgjë mbi konfidencialitetin, qoftë dhe në parim. Absolutisht

asgjë për mbrojtjen e të dhënave sensitive të pacientëve kryesisht, duke patur parasysh rëndësinë që ka përpunimi i të dhënave të tyre, në fushën e shëndetësisë si fushë me ndjeshmëri të lartë në mbrojtjen e të dhënave personale.

2-Kontrolluesit, klinika "GLOBE" sh.p.k., nuk aplikon deklaratë konfidencialiteti e cila është detyrim për çdo punëmarrës, si një mekanizëm në të cilin parashikohen penalitete për punëmarrësin që nuk ruan konfidencialitetin dhe privatësinë e pacientit. Në kontratën individuale dhe rregulloren e përgjithshme, e kanë si parashikim në kontraktor, por jo të formatuar si e kërkon detyrimisht Vendimi nr.6, datë 05.08.2013. Deklarata e konfidencialitetit, është detyrim për çdo punëmarrës. Parë në frymën e ligjit (pika 2/dh neni 7 dhe neni 28), kontrolluesi duhet të aplikojë deklaratën e konfidencialitetit për të gjithë punonjësit, gjë e cila do të ishte një ndër masat kryesore e cila do të garantonte privatësinë e pacientëve/klientëve të tij.

3-Kontrolluesi, në marrëdhëniet kontraktuale me të tretët, nuk i bashkangjit kontratës bazë, aneks kontratën tip, për përpunimin e të dhënave personale nga palë të treta, sipas Udhëzimit Nr.19, datë 03.08.2012 të Komisionerit, "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip, në rastet e këtij delegimi", tagër më së shumti ky, në këtë rast i kompanive sigurorese, se sa i klinikës "GLOBE" sh.p.k. Kjo nuk do të thotë se, kur kontrolluesi është në kushtet e përpunuesit, të mos e iniciojë vetë ai këtë marrëveshje konfidencialiteti.

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit, si dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87 e vazhdim të Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, në datë 01.03.2016 është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit, lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Në zbatim të nenit 87 të Kodit të Procedurës Administrative, i ndryshuar, është njoftuar kontrolluesi-klinika "GLOBE" sh.p.k. për ezaurimin e të drejtës së tij për tu dëgjuar, por përfaqësuesit e tij nuk u paraqitën në seancë dëgjimore, edhe pse janë vënë në dijeni për këtë procedurë, në datë 17.02.2016. Kontrolluesi-klinika "GLOBE" sh.p.k., nuk ka paraqitur pretendimet e tij, as dhe me shkrim.

Rezulton se, kontrolluesi është në shkelje të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Kontrolluesi ka patur gjithë mundësinë për t'u njohur me ligjin dhe detyrimet që rrjedhin nga ky ligj, dhe aktet e tjera nënligjore.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrative në kuptim të nenit 39/1 shkronja "a" dhe "dh" të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) "kontrolluesit, që përdorin të dhëna në kundërshtim me kreun II "Përpunimi i të dhënave personale". dënohen me 10.000 deri në 500.000 lekë"

dh) "kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk

zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë."

Kontrolluesi, klinika "GLOBE" sh.p.k., në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me sigurinë e të dhënave personale, detyrimin për informim, si një e drejtë parësore në zbatim të ligjit dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale. Komisioneri gjithashtu, ka parasysh faktin që kontrolluesi ka qënë në bashkëpunim serioz me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 7 paragrafi 2, gërma "dh", 27, 28, 30, 31, 39/1 shkronja "a" dhe "dh", 39/2, 40 dhe 41 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

V E N D O S A :

1. Dënimin e kontrolluesit, klinika "GLOBE" sh.p.k., me gjobë, në vlerën **100 000 (njëqindmijë) lekë**, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në kreun II, nenin 7, paragrafi 2, gërma "dh" të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit, klinika "GLOBE" sh.p.k., me gjobë, në vlerën **100 000 (njëqindmijë) lekë**, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27, 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Kontrolluesi, "GLOBE" sh.p.k., në marrëdhëniet kontraktuale me të tretët, kur gjendet në kushtet e përpunuesit, duhet domdoshmërisht të realizojë dhe të bashkëpunojë me palën, e cila e pajton për kryerjen e shërbimit "chek-up", për aneks kontratën tip, mbi përpunimin e të dhënave personale nga palë të treta, sipas Udhëzimit Nr.19, datë 03.08.2012 të Komisionerit.
4. Kontrolluesi "GLOBE" sh.p.k., të rikuperojë shkeljet e konstatuara nga grupi i kontrollit brenda një periudhe prej 30 ditësh.
5. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot në, 10.3, 2016

Besnik DERVISH

KOMISIONERI

